



PROJEKT-PROPOZIM

TITULLI I PROJEKTIT	“Këndi i Qetësisë – Hapësirë për mirëqenie emocionale dhe përqendrim”
HARTUESIT E PROJEKTIT	Nxënësit e shkollës së mesme “Myslym Keta” nën mentorimin e stafit pedagogjik
VENDI I ZBATIMIT TË PROJEKTIT	Shkolla e mesme “Myslym Keta”, Bashkia Tiranë
KOHËZGJATJA E PROJEKTIT	6 muaj
BUXHETI TOTAL	250,000 lekë (ALL)

ANALIZA E KONTEKSTIT AKTUAL DHE PËRSHKRIMI I GRUPIT TË SYNUAR

Shkolla e mesme “Myslym Keta”, që ndodhet në një zonë urbane të Tiranës, përballet me një realitet dinamik dhe sfidues për të rinjtë. Nxënësit janë të ekspozuar ndaj presioneve të ndryshme, që nga ngarkesa mësimore dhe pritshmëritë akademike, deri te ndikimet e teknologjisë, mungesa e hapësirave sociale, si dhe sfidat emocionale që vijnë nga periudha e adoleshencës. Në një mjedis të tillë, nevoja për mirëqenie mendore dhe qasje të reja që promovojnë qetësinë, vetë-reflektimin dhe vetëkontrollin është bërë gjithnjë e më e rëndësishme. Shkolla aktualisht nuk ka një hapësirë të dedikuar që të shërbejë si një zonë neutraliteti emocional, ku nxënësit të mund të tërhiqen për pak minuta qetësi, lexim, relaksim ose ushtrime të vetëkontrollit. Ambientet ekzistuese si klasat, korridoret ose oborri nuk ofrojnë privatësi apo kushtet e nevojshme për t’u çlodhur nga stresi i përditshëm. Mungesa e një hapësirë të tillë ndikon në përqendrimin e nxënësve gjatë orëve të mësimit, rrit nivelin e tensionit ndërmjet tyre dhe kufizon zhvillimin e aftësive për menaxhimin e emocioneve. Gjatë konsultimeve me mësuesit dhe psikologun e shkollës, është konstatuar se një pjesë e nxënësve



shfaqin simptoma të ankthit të lehtë, lodhje kronike dhe vështirësi në komunikim me bashkëmoshatarët ose stafin. Këto sinjale e bëjnë edhe më urgjente

nevojën për ndërhyrje që ndihmon në vetë-rregullimin emocional dhe krijimin e një ambienti të sigurt psikologjik brenda shkollës.

Për më tepër, pandemia COVID-19 dhe pasojat e saj në shëndetin mendor të të rinjve kanë lënë gjurmë afatgjata. Izolimi, ndarja nga mjediset sociale dhe humbja e rutinës normale kanë ndikuar në gjendjen emocionale të shumë nxënësve. Edhe pse shkollat janë kthyer në normalitet, ndikimi i kësaj periudhe mbetet i ndjeshëm dhe kërkon forma të reja të përkujdesjes për mirëqenien e nxënësve. Në këtë kontekst, krijimi i një "Këndi të Qetësisë" është një zgjidhje e thjeshtë, por me impakt të madh. Një hapësirë e tillë mund të shërbejë si mjet parandalues për konflikte, rritje të performancës në mësim dhe përmirësim të klimës shkollore në tërësi. Një vend ku nxënësit të mund të meditojnë, të lexojnë ose të qëndrojnë në heshtje për disa minuta mund të ketë efekte pozitive të menjëhershme në sjelljen dhe mirëqenien e tyre.

Grupi i synuar i këtij projekti janë të gjithë nxënësit e shkollës "Myslym Keta", me fokus të veçantë tek ata që kanë nevojë për më shumë mbështetje në menaxhimin e emocioneve dhe përqendrimit. Ndërkohë, projekti do të përfshijë edhe stafin mësimor dhe psikologun e shkollës, të cilët do të ndihmojnë në funksionimin dhe mirëmbajtjen e hapësirës, si dhe do të promovojnë përdorimin e saj në mënyrë të strukturuar dhe edukative. Përmes këtij projekti, shkolla jo vetëm që do të përmbushë një nevojë të kahershme por edhe do të dërgojë një mesazh të qartë se kujdesi për shëndetin mendor dhe mirëqenien psikologjike është po aq i rëndësishëm sa edhe suksesi akademik. Kjo nismë do të ndihmojë në krijimin e një klime më të shëndetshme, të barabartë dhe gjithëpërfshirëse në institucionin arsimor.



PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti “Këndi i Qetësisë” synon të krijojë një hapësirë të dedikuar brenda shkollës së mesme “Myslym Keta” në Tiranë, ku nxënësit mund të kalojnë një kohë të shkurtër për të pushuar, reflektuar, lexuar, medituar ose thjesht për të qëndruar në qetësi. Ky projekt vjen si përgjigje ndaj nevojës për të promovuar mirëqenien mendore dhe qasjet e shëndetshme për menaxhimin e stresit dhe emocioneve në mjedisin shkollor. Projekti parashikon identifikimin dhe përshtatjen e një hapësire ekzistuese në shkollë për ta shndërruar atë në një ambient të qetë dhe mikpritës. Ambienti do të mobilizohet me elementë të dizajnuar për qetësim dhe relaks, si: tapete, kolltukë, kënde leximi, ndriçim i butë, bimë dekorative, rafte me libra motivues dhe kartolina me mesazhe pozitive. Gjithashtu do të vendosen pajisje ndihmëse si fletore për shënime personale dhe udhëzime për vetë-reflektim.

Kjo hapësirë do të jetë në dispozicion të nxënësve gjatë pushimeve para ose pas orëve të mësimt dhe në raste të veçanta kur mësuesit ose psikologu e konsiderojnë të nevojshme të sugjerojnë pushim për ndonjë nxënës. Qëllimi nuk është të zëvendësohet ndihma psikologjike e specializuar, por të ofrohet një mundësi alternative dhe preventive që forcon ekuilibrin emocional dhe zhvillon aftësitë për vetë-rregullim. Një nga komponentët më të rëndësishëm të projektit është edukimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit shkollor mbi rëndësinë e mirëqenies mendore. Për këtë arsye, do të organizohen aktivitete sensibilizuese dhe trajnime të shkurtra për nxënësit dhe mësuesit mbi përdorimin efektiv të këndit të qetësisë, teknika relaksuese dhe mënyra për të ruajtur një klimë pozitive në shkollë. Përdorimi i kësaj hapësire do të jetë i strukturuar dhe i monitoruar. Do të hartohet një udhëzues i shkurtër mbi rregullat e sjelljes në këtë hapësirë, i cili do të vendoset në hyrje dhe do të promovohet përmes fletëpalosjeve, prezantimeve dhe materialeve vizuale. Nxënësit do të ftohen që të bëhen pjesë aktive në mirëmbajtjen e ambientit dhe pasurimin e tij me ide krijuese, siç janë ilustrimet me mesazhe pozitive ose krijimi i një “libri të qetësisë” ku të ndajnë mendime e reflektime.

Përveç impaktit të drejtpërdrejtë të nxënësit, projekti synon të përçojë një kulturë të re në shkollë – një kulturë që vlerëson empatinë, dëgjimin aktiv dhe kujdesin për veten dhe tjetrin. Në një realitet ku të rinjtë përballen çdo ditë me sfida të mëdha akademike, sociale dhe emocionale, ky kënd do të shërbejë si simbol i vëmendjes ndaj nevojave emocionale dhe



zhvillimit të qëndrueshëm personal. Në fund të periudhës së zbatimit të projektit, do të realizohet një event promovues ku do të prezantohet zyrtarisht “Këndi i Qetësisë” dhe do të ndahen përvoja të nxënësve që e kanë përdorur atë. Ky aktivitet do të jetë gjithashtu një mundësi për të përfshirë komunitetin lokal, prindërit dhe partnerë të mundshëm që mund të mbështesin zgjerimin ose përsëritjen e iniciativës në shkolla të tjera. Kështu, projekti jo vetëm që përmbush një nevojë të menjëhershme në shkollën “Myslym Keta”, por edhe kontribuon në modelimin e praktikave të mira për arsimin gjithëpërfshirës dhe mirëqenien e të rinjve.

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM DHE OBJEKTIVI SPECIFIK

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM

Të përmirësojë mirëqenien emocionale dhe përfshirjen sociale të nxënësve në shkollën e mesme “Myslym Keta” përmes krijimit të një hapësire të sigurt, të qetë dhe mikpritëse – “Këndit të Qetësisë” – e dedikuar për relaksim, reflektim dhe vetë-rregullim emocional.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1:

Të rikonstruktojë dhe pajisë një ambient të brendshëm të shkollës si “Kënd i Qetësisë”, duke e kthyer në një hapësirë funksionale për mirëqenie dhe qetësi brenda 3 muajve nga fillimi i projektit.

Indikatorë të matshëm për Objektivin Specifik 1:

- 1 ambient i shkollës i rikonstruktuar dhe përshtatur si kënd qetësie.
- Të paktën 30 pajisje relaksuese dhe materiale didaktike të vendosura (kolltukë, tapetë, libra, lodra antistres, ndriçim ambiental etj.).
- 1 plan menaxhimi për mirëmbajtjen dhe përdorimin e hapësirës, i miratuar nga drejtoria e shkollës.

OBJEKTIVI SPECIFIK 2:



- Të promovojë përdorimin aktiv dhe të ndërgjegjshëm të “Këndit të Qetësisë” nga nxënësit përmes aktiviteteve ndërgjegjëse dhe informuese mbi menaxhimin e emocioneve dhe shëndetin mendor.

Indikatorë të matshëm për Objektivin Specifik 2:

- Të paktën 100 nxënës të regjistruar në listën e përdoruesve të rregullt të këndit gjatë 6 muajve të parë.
- Të paktën 3 aktivitete ndërgjegjësimi të realizuara (prezantime, orë edukative, fletëpalosje, postera motivues).
- 1 bashkëpunim i vendosur me psikologun e shkollës dhe 3 mësues për orientimin e përdorimit të këndit.

AKTIVITETET

Aktiviteti 1: Përshtatja dhe mobilimi i hapësirës për “Këndin e Qetësisë”

Ky aktivitet përfshin identifikimin dhe transformimin e një ambienti të brendshëm të shkollës, i cili aktualisht është në përdorim të pjesshëm ose i papërdorur, në një hapësirë të rehatshme dhe funksionale për relaksim dhe vetë-reflektim. Përzgjedhja e ambientit do të bëhet në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës, duke marrë në konsideratë lehtësinë e aksesit për nxënësit dhe distancën nga zonat me zhurmë. Pas përzgjedhjes së hapësirës, do të zhvillohet një plan i detajuar për rikonstruksionin bazë (ndriçimi, muret, dyshemeja) në mënyrë që ambienti të jetë estetikisht i qetë dhe frymëzues. Do të përdoren ngjyra të ngrohta dhe elementë që nxisin ndjesinë e sigurisë dhe relaksit. Kjo përfshin edhe instalimin e ndriçimit ambiental dhe perdeve për të krijuar privatësi të pjesshme. Pajisja e këndit do të përfshijë kolltukë ose qese fasulesh për ulje, tapetë, tavolina të vogla, libra frymëzues, lodra antistres dhe postera me mesazhe pozitive. Elementët do të përzgjidhen në konsultim me nxënësit dhe psikologun e shkollës, për të siguruar që hapësira i përgjigjet nevojave të tyre emocionale dhe estetike.



Qëllimi është të krijohet një ambient që nuk perceptohet si një klasë tjetër, por si një vend i sigurt dhe joshës për ndalje, reflektim, apo qetësim në momente stresi. Përdoruesit e tij mund të jenë nxënës me shqetësime emocionale, nxënës që kanë nevojë për një pushim të shkurtër nga dinamika e orëve mësimore, apo thjesht ata që kërkojnë një vend për lexim të qetë.

Ky aktivitet është themeli i të gjithë projektit, pasi pa hapësirën fizike të përshtatshme, nuk mund të realizohen aktivitetet e tjera. Kjo hapësirë do të menaxhohet në bashkëpunim me psikologun e shkollës dhe një mësues kujdestar, të cilët do të kenë rol në monitorimin dhe mirëmbajtjen e saj.

Aktiviteti 2: Realizimi i një fushate ndërgjegjësimi për shëndetin emocional dhe menaxhimin e stresit

Pasi të krijohet “Këndi i Qetësisë”, do të organizohet një fushatë informuese dhe ndërgjegjësuere në shkollë për rëndësinë e shëndetit emocional dhe menaxhimit të stresit. Aktiviteti do të zhvillohet në bashkëpunim me psikologun dhe stafin mësimor dhe do të ketë në fokus edukimin e nxënësve mbi mënyrat e shëndetshme të përballimit të emocioneve. Fushata do të përfshijë postera informues në korridoret e shkollës, shpërndarjen e fletëpalosjeve me këshilla praktike për relaksim, dhe sesione të shkurtra informuese gjatë orëve të edukimit qytetar apo edukimit shëndetësor. Gjithashtu, do të organizohen edhe diskutime në klasë për t’i dhënë hapësirë nxënësve të shprehin përvojat dhe mendimet e tyre. Mesazhet kryesore të fushatës do të fokusohen në normalizimin e emocioneve negative, domosdoshmërinë e të kërkuarit ndihmë, dhe fuqizimin e ideve pozitive rreth kujdesit për mirëqenien mendore. Nxënësit do të mësojnë se “nuk është dobësi të kërkojë ndihmë” dhe se të qënurit emocionalisht i qëndrueshëm është një aftësi që mund të mësohet dhe zhvillohet. Fushata do të promovojë gjithashtu përdorimin e “Këndit të Qetësisë” si një mjet për vetëmenaxhimin e emocioneve dhe si një resurs i vlefshëm në shkollë. Përfshirja e nxënësve në këtë fushatë (përgatitja e materialeve, prezantimi i mesazheve) do të nxisë ndjenjën e pronësisë dhe angazhimit. Ky aktivitet do të shërbejë si një ndërhyrje kulturore që synon të krijojë një klimë të hapur e mbështetëse në shkollë, ku shëndeti emocional shihet si pjesë integrale e suksesit akademik dhe zhvillimit personal të nxënësve.



Aktiviteti 3: Trajnimi i stafit mësimor dhe psikologut për përdorimin e këndit dhe qasjen ndaj nxënësve në nevojë

Për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm dhe efektiv të këndit, do të realizohet një trajnim një-ditor për mësuesit kujdestarë, psikologun dhe përfaqësues të stafit ndihmës. Trajnimi do të fokusohet në temat e ndërhyrjes bazë emocionale, krijimin e një klime mbështetëse në klasë dhe mënyrën e referimit të nxënësve në këndin e qetësisë. Trajnimi do të realizohet me një ekspert të fushës së psikologjisë shkollore dhe do të përfshijë elementë praktikë: role-play për situata të zakonshme me nxënës të shqetësuar, zhvillimin e një protokollit etik për përdorimin e këndit dhe strategji për mbështetjen afatshkurtër të nxënësve. Një pjesë e rëndësishme e trajnimit do të jetë edhe ndërgjegjësimi i stafit mbi rolin që ata luajnë në shëndetin emocional të nxënësve – nga mënyra e komunikimit, tek vëzhgimi i sinjaleve të stresit dhe ndihma në raste urgjente. Përfshirja e gjithë stafit do të sigurojë koherencë dhe përgjegjësi të përbashkët.

Përmes këtij aktiviteti do të krijohet një rrjet mbështetjeje brenda shkollës, duke rritur kapacitetin institucional për të identifikuar, referuar dhe ndihmuar nxënësit në vështirësi. Do të përgatiten gjithashtu materiale orientuese (udhëzues për stafin) për të standardizuar qasjen ndaj përdorimit të këndit. Aktiviteti do të ndikojë drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë e projektit duke siguruar që pas përfundimit të tij, shkolla të ketë një strukturë të qartë dhe të funksionalizuar për menaxhimin e emocioneve të nxënësve në mënyrë të përgjegjshme dhe sistematike.

Aktiviteti 4: Organizimi i “javës së mirëqenies” me aktivitete gjithëpërfshirëse për nxënësit



Ky aktivitet parashikon zhvillimin e një jave të dedikuar mirëqenies emocionale dhe sociale të nxënësve, me qëllim promovimin e sjelljeve të shëndetshme dhe forcimin e lidhjeve pozitive mes bashkëmoshatarëve. Aktiviteti do të zhvillohet në muajin e dytë pas krijimit të këndit, për të rritur ndërgjegjësimin dhe përfshirjen. Gjatë javës do të organizohen aktivitete të ndryshme si: yoga në grup, seanca meditimi të udhëhequra, lojëra bashkëpunimi, ditë pa celularë, kënd i “shkresave pozitive” ku nxënësit i shkruajnë njëri-tjetrit mesazhe motivuese dhe panair i librave të mirëqenies. Aktivitetet do të

planifikohen nga një grup vullnetar nxënësish në bashkëpunim me psikologun dhe koordinatorin e projektit. Kjo nxit pjesëmarrje aktive dhe krijon një ndjenjë komuniteti ku të gjithë kontribuojnë në përmirësimin e klimës shkollore. Kjo javë do të përdoret edhe për të promovuar “Këndin e Qetësisë”, me guida të hapura, prezantime për klasat dhe mundësi për vizitë të lirë nga nxënësit. Do të mbahen edhe aktivitete ndërgjegjësuese për prindërit përmes takimeve dhe komunikimeve të personalizuar. Ky aktivitet do të ndikojë në normalizimin e praktikave të kujdesit për veten dhe do të krijojë një kulturë pozitive në shkollë që do të zgjasë përtej periudhës së projektit, duke e bërë mirëqenien një temë të pranishme dhe të integruar në jetën shkollore.

Aktiviteti 5: Monitorimi dhe vlerësimi i përdorimit dhe impaktit të këndit të qetësisë

Për të siguruar që projekti është efektiv dhe plotëson objektivat e tij, do të realizohet një sistem monitorimi dhe vlerësimi të përdorimit të këndit. Do të krijohen instrumente të thjeshta si: regjistër përdorimi, formular reflektimi për nxënësit pas vizitës në kënd dhe pyetësorë vlerësimi për fundvitin shkollor.

Psikologu i shkollës dhe koordinatori i projektit do të bashkëpunojnë për të përpiluar raporte mujore për përdorimin e këndit, frekuentimin dhe vlerësimet nga nxënësit. Këto të dhëna do të ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të funksionimit dhe mund të përdoren për të justifikuar zgjerimin e nismës në të ardhmen. Gjithashtu, do të zhvillohet një takim përmbyllës me pjesëmarrjen e stafit mësimor, drejtuesve të shkollës, përfaqësuesve të bashkisë dhe organizatave partnere për të ndarë rezultatet e arritura, sfidat dhe mësimet e nxjerra. Ky aktivitet do të ndihmojë në dokumentimin dhe institucionalizimin e praktikave të mira, duke siguruar që “Këndi i Qetësisë” të mos mbetet vetëm një iniciativë e përkohshme, por të bëhet pjesë e politikave të brendshme të shkollës për kujdesin ndaj nxënësve.



Vlerësimi do të ndihmojë edhe në përcaktimin e nevojës për përmirësime të mëtejshme dhe do të jetë bazë për aplikime të ardhshme për mbështetje financiare ose zgjerim të projektit në shkollat të tjera në Bashkinë Tiranë.

REZULTATET E PRITSHME

Rezultati i Pritshëm 1: Krijimi i një hapësire të dedikuar për mirëqenie emocionale dhe menaxhim të stresit në shkollë.

Indikatorët e matshëm:

- Një ambient i përshtatur dhe funksional për "Këndin e Qetësisë" brenda 1 muaji nga fillimi i projektit.
- Së paku 5 elementë bazë të instaluar në hapësirë (mobilie relaksuese, ndriçim i përshtatur, libra, postera, lodra antistres).
- Rreth 80% e nxënësve të informuar mbi ekzistencën dhe funksionin e këndit (përmes fushatës së brendshme informuese).

Rezultati i Pritshëm 2: Rritja e vetëdijes së nxënësve për rëndësinë e shëndetit emocional dhe aftësive për menaxhimin e stresit.

Indikatorët e matshëm:



- Minimumi 1 fushatë ndërgjegjësimi e zhvilluar në shkollë me pjesëmarrjen e së paku 200 nxënësve.
- Shpërndarja e të paktën 150 fletëpalosjeve ose materialeve promovuese mbi mirëqenien mendore.
- 70% e nxënësve që marrin pjesë në një anketim pas fushatës shprehin se e konsiderojnë të rëndësishëm kujdesin emocional dhe do të përdorin këndin e qetësisë në të ardhmen.

Rezultati i Pritshëm 3: Rritja e kapaciteteve të stafit për të mbështetur mirëqenien emocionale të nxënësve.

Indikatorët e matshëm:

- Minimumi 10 anëtarë të stafit të trajnuar mbi përdorimin e këndit dhe strategjitë për mbështetjen emocionale të nxënësve.
- Hartimi dhe shpërndarja e një udhëzuesi praktik për mësuesit dhe psikologun për referimin e nxënësve.
- 90% e stafit të trajnuar vlerëson trajnimet si të dobishme dhe të aplikueshme në praktikën e përditshme (bazuar në formularë vlerësimi).

Rezultati i Pritshëm 4: Rritja e angazhimit të nxënësve në promovimin e mirëqenies në shkollë.

Indikatorët e matshëm:

- Të paktën 1 javë e dedikuar për mirëqenien emocionale (Java e Mirëqenies) e zhvilluar me pjesëmarrjen aktive të nxënësve.
- Minimumi 4 aktivitete të zhvilluara gjatë javës (p.sh. joga, ditë pa celularë, këndi i shkresave pozitive, lexime të udhëzuara).
- Së paku 20 nxënës të angazhuar si vullnetarë në organizimin e aktiviteteve.

Rezultati i Pritshëm 5: Sigurimi i qëndrueshmërisë së iniciativës përmes monitorimit dhe reflektimit të rregullt.

Indikatorët e matshëm:

- Një sistem i thjeshtë monitorimi (regjistër përdorimi, formular reflektimi) funksional brenda 2 javëve pas hapjes së këndit.



- Minimumi 1 raport përmbledhës mbi përdorimin dhe impaktin e këndit i hartuar në fund të projektit.
- Së paku 70% e nxënësve që kanë përdorur këndin raportojnë përmirësim të gjendjes emocionale ose ndjenjë lehtësimi (bazuar në formularët e reflektimit).

Aktiviteti	M1	M2	M3	M4	M5	M6
1. Rikonstruksioni dhe mobilimi i hapësirës për Këndin e Qetësisë	✓	✓				
2. Fushatë ndërgjegjësuese për shëndetin mendor në mjedisin shkollor		✓	✓			
3. Trajnimi i stafit për menaxhimin e emocioneve dhe referimin e nxënësve			✓	✓		
4. Java e Mirëqenies me aktivitete të dedikuara për nxënësit				✓		



5. Monitorimi, reflektimi dhe dokumentimi i përdorimit të këndit				✓	✓	✓
--	--	--	--	---	---	---

Indikatorët kryesorë (në përputhje me objektivat):

Objektivi / Rezultati	Indikatorë të Matshëm
Objektivi i Përgjithshëm: Promovimi i mirëqenies emocionale dhe mendore të nxënësve në shkollë përmes krijimit të një hapësire të dedikuar për qetësim.	- 1 kënd i qetësisë i krijuar dhe funksionalizuar brenda 3 muajve të parë.- 60% e nxënësve ndihen më të qetë pas përdorimit të këndit (anketë vlerësimi).
Objektivi Specifik 1: Krijimi i një hapësire funksionale për qetësi dhe reflektim.	- 1 hapësirë e përshtatur dhe e mobiluar brenda muajit të 2-të.- 100 nxënës e kanë përdorur hapësirën brenda 3 muajve nga hapja.
Rezultati 1: Këndi i qetësisë është ndërtuar dhe mobiluar sipas standardeve.	- Hapësira e dekoruar, e pajisur me mobilie të rehatshme dhe mjedis të qetë.- Hapësira



	vizitohet rregullisht nga nxënësit gjatë pushimeve.
Objektivi Specifik 2: Rritja e ndërgjegjësimin për mirëqenien emocionale dhe menaxhimin e stresit.	- 2 trajnime për stafin dhe mësuesit.- 150 nxënës marrin pjesë në aktivitetet për mirëqenie.- 4 aktivitete ndërgjegjëse të realizuara.
Rezultati 2: Stafi dhe nxënësit të trajnuar dhe të angazhuar në promovimin e mirëqenies.	- Përmirësim në komunikim dhe menaxhim emocionesh mes nxënësve (vlerësuar përmes fokus-grupeve).- Aktivizimi i vullnetarëve për menaxhimin e këndit.

BUXHETI I PROJEKTIT

Aktiviteti	Përshkrimi i Shpenzimeve	Buxheti i Përafërt (ALL)
Aktiviteti 1: Rikonstruksioni i hapësirës	Rifreskimi i mureve, ndriçim i ngrohtë, perde dhe izolim akustik për hapësirën e këndit të qetësisë	70,000 ALL



Aktiviteti 2: Mobilimi dhe dekorimi	Tavolina të ulëta, pufa, jastekë relaksues, tapet, raft librash, elementë dekorativë qetësues	85,000 ALL
Aktiviteti 3: Blerja e materialeve relaksuese	Libra motivues, mjete arti për reflektim (bojëra, fletore, lapsa ngjyrash), lojëra logjike antistres	40,000 ALL
Aktiviteti 4: Trajnimi i stafit dhe orientimi i nxënësve	Pagesa për trajnerin dhe organizimi i 2 sesioneve trajnimi mbi mirëqenien emocionale	25,000 ALL
Aktiviteti 5: Promovimi dhe vizibiliteti	Printim posterash, fletëpalosje, foto për rrjetet sociale dhe video e shkurtër për promovim	20,000 ALL
Aktiviteti 6: Shpenzime të tjera logjistike	Menaxhim projekti, materiale kancelarie, transport, mirëmbajtje	10,000 ALL
TOTALI		250,000 ALL

VIZIBILITETI I PROJEKTIT



Për të siguruar një impakt sa më të gjerë dhe ndërgjegjësime për projektin "Këndi i Qetësisë", është hartuar një plan vizibiliteti që mbështet pjesëmarrjen aktive të komunitetit shkollor dhe më gjerë. Ky plan synon promovimin e projektit gjatë të gjithë ciklit të zbatimit, nga faza e përgatitjes deri në përmbyllje, përmes mjeteve të ndryshme informimi dhe komunikimi. Së pari, që në fazën përgatitore, projekti do të promovohet përmes njoftimeve dhe posterave informues të vendosura në hapësirat më të frekuentuara të shkollës. Këto materiale do të shërbejnë për të rritur kuriozitetin dhe përfshirjen e nxënësve në fazën e konsultimit mbi dizajnin dhe nevojat që do të adresojë këndi i qetësisë. Gjatë zbatimit të projektit, përditësime të rregullta do të postohen në rrjetet sociale të shkollës si edhe në tabelën e informimit të institucionit. Nxënësit do të jenë të angazhuar në krijimin e përmbajtjeve vizuale si video të shkurtra, fotografi të fazave të zbatimit dhe mesazhe motivuese që lidhen me mirëqenien emocionale dhe menaxhimin e stresit.

Në përfundim të projektit, do të organizohet një event përrues, ku do të ftohen jo vetëm nxënësit dhe stafi pedagogjik, por edhe prindër, përfaqësues të Bashkisë Tiranë dhe aktorë të tjerë të komunitetit lokal. Ky aktivitet do të shërbejë si një moment reflektimi mbi rëndësinë e krijimit të hapësirave të dedikuara për mirëqenie dhe si model që mund të përsëritet në shkolla të tjera.

Së fundi, do të përgatitet një raport vizual me foto dhe përshkrime të projektit, i cili do të shpërndahet në rrjetet sociale dhe do t'i përcillet partnerëve të mundshëm për bashkëpunim në të ardhmen. Përmes këtij plani vizibiliteti, projekti synon të jetë jo vetëm një ndërhyrje funksionale brenda shkollës, por edhe një shembull frymëzues për komunitetin më të gjerë arsimor.